



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. _____/2021

Dt. 26.02.2021

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin 7 paragrafi 3 të Ligjit nr.04/L-076 për Policinë dhe nenin 9 paragrafi 1.7 të Udhëzimit Administrative nr. 27/2012 MPB -03/2012-MAPL-së për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkës, në mbledhjen e mbajtur me dt.26.02.2021, pas diskutimeve lidhur me pikën e 5 të Rendit të ditës : Miratimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2021, e miratoi këtë:

V e n d i m P ë r

miratimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021

- 1.Miratohet Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Komunën e Gjakovës për vitin 2021.
- 2.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

4.Vendimi iu dërgohet:

- z. Ardian Gjini , Kryetar i Komunës së Gjakovës
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës,
- Arkivit,

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Anton Shala



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



PLANI I PUNËS
SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI
(KKSb) PËR VITIN 2021

Gjakovë - 2021

PLANI I PUNËS SË KKSBS-së për VITIN 2021

Nr. rendor	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	Bartësit e aktiviteteve	Rezultatet e pritura	Afati kohor	Burimet financiare
1	Bashkërendimi i iniciativave të përbashkëta të mekanizmave institucional për zgjidhjen e problemeve të sigurisë të çdo komuniteti	Hartimi i Planit të punës së KKSBS-së	Anëtarët e KKSBS-së	- Ndërmerrjen iniciativa të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve për siguri në Bashkësi	Janar	Nuk ka implikime buxhetore
2	Sensibilizimi i qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitet si dhe identifikimi i brengave lidhur me sigurinë publike	Organizimi i së paku 6 mbledhjeve të rregullta të KKSBS-së - Organizimi i 12 takimeve me qytetarë në Bashkësi Lokale me problematika të theksuara	Anëtarët e KKSBS-së (anëtarët caktohen pas çdo mbledhjeje të KKSBS-së	-Rritet vetëdijësimi i qytetarëve për natyrën e krimeve; -Identifikohen brengat e qytetarëve për sigurinë publike	Janar-Dhjetor	Buxheti Komunal
3	Rritja e bashkëpunimit të mekanizmave institucional nga lëmia e sigurisë publike	Rivitalizimi i Këshillave Lokale për Siguri në Bashkësi dhe mbajta e trajnimeve të tyre.	Anëtarët e KKSBS-së, KLSB	-Rezultatat përvojash nga fusha e sigurisë publike	Mars-Qershor	Buxheti Komunal, Donacione
4	Siguria në shkollat fillore dhe ato të mesme, -Siguria e nxënësve në trafik, -Mirëmbajtja e video kamerave	-Patrullimi i rregullt i Policisë, posaçërisht gjatë fillimit dhe mbarimit të orarit mësimor, vendosja e barrierave të komunikacionit në afërsi të shkollave, mbajta e ligjëratave nëpër shkolla nga ana e Policisë lidhur me	Policia e Kosovës, Kuvendi Komunal dhe DA, DSHP	Minimizimi i incidenteve mes nxënësve, parandalimi i akteve joligjore	Janar-Dhjetor	Buxheti i PK-së Komunal, Donacione

		sigurinë në komunikacion, raportimi i DA-së mbi gjendjen e sigurisë				
5	-Vendosja dhe funksionalizimi i kamerave shtesë të sigurisë në hapësira publike në rrugët kryesore në qytetin e Gjakovës	-Realizimi i projektit për vendosjen e kamerave shtesë	Komuna e Gjakovës	-Ngritja e Sigurisë së përgjithshme publike, -Funksionalizimi i QOE-(Qendra Operative Komunale Emergjente)	Janar-Dhjetor	Buxheti Komunal, Donacione
6	-Sensibilizimi i të rinjve për mbrojtje nga dukuritë negative që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre (rreziku nga përdorimi i narkotikëve, ndalimi i fëmijëve në klubet e natës) me theks të veçantë në shkolla të mesme dhe hapësira të shkollave të mesme, në bazë të ligjit në fuqi -Informimi i nxënësve për dhenien e ndihmës së parë	-Kampanjë: Mbatja e ligjëratave në shkollat e Komunës së Gjakovës nga ekspertët e mjekësisë të specializimeve përkatëse	KKSB, DA, DSHMS, Kryqi i Kuq, Nj.K.D.Nj OJQ- të, Inspektorati komunal dhe Policia e Kosovës	-Ngritja e vetëdijesimit nga rreziku i përdorimit të narkotikëve, dhënies së ndihmës së parë, Informacion mbi zbatimin e ligjit	Janar-Dhjetor	Buxheti Komunal, Donacione
7	-Parandalimi, mbrojtja dhe luftimi i trafikimit me genie njerëzore, -Parandalimi i dhunës në familje. -Vetëdijesimi i fëmijëve lidhur me llojet e dhunës dhe parandalimi i dhunës, vetëdijesimi i fëmijëve lidhur me të drejtat e fëmijëve, -Luftimi i trafikimit me genie njerëzore dhe prostitucion., Fëmijët Iypsar	-Mbatja e ligjëratave në shkollat e Komunës së Gjakovës dhe formimi i Task Forcës	KKSB,DA, Shkollat DSHMS, Kryqi i Kuq, QPS, Policia e Kosovës, Nj.K.D.Nj OJQ-të Gjakove.	-Ngritja e vetëdijesimit nga rreziku i trafikimit me genie njerëzore, dhe ngritja e bashkëpunimit ndër institucional në luftimin dhe parandalimin e dhunës në familje. -Formimi ekupeve vepruese për parandalimin e dukurive negative(ne shkollat e mesme)	Janar - Dhjetor	Buxheti Komunal Donacione

8	Monitorimi i funksionimit të këshillave shkollore të komunës së Gjakovës.	-Bashkëpunimi me DKA dhe me këshillat e prindërve	KKSB, DA, OJQ-te	-Ngritja e pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e sigurisë publike dhe minimizimi i incidenteve mes tyre.	Janar- Dhjetor	Nuk ka implikime buxhetore
9	Ndalimi i përdorimit të armëve dhe kufizimi i mjeteve piroteknike gjatë ahengjeve	-Mbahija e ligjëratave, përgatitja dhe shpërndarja e broshurave, postareve etj.	Policia e Kosovës, drejtoria e Inspeksionit dhe mediat	Ngritja e sigurisë së përgjithshme publike, Zvogëlimi i rasteve të identiteve gjatë festave dhe ahengjeve familjare	Qershor - Dhjetor	Buxheti Lokal dhe Qendror
10	-Siguria në Komunikacion (Patrullimi i PK, shenjëzimi dhe vendosja e tregueseve të komunikacionit aty ku mungojnë dhe ku është e nevojshme), monitorimi i rregullimeve të trotuareve nëpër vendbanime.	-Vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale në komunikacion	DSHP dhe Policia e Kosovës	Ngritja e sigurisë së përgjithshme publike, Zvogëlimi i rasteve të identiteve në komunikacion	Janar- Dhjetor	Buxheti Lokal
11	-Parandalimi i prejtjes së pakontrolluar të pyjeve, -Parandalimi i eksploatimit të rërës dhe zhavorrit. -Mbrojtja e pyjeve nga zjarri -Mbrojtje nga vërshimet dhe tërmete	-Mbahija e takimeve me qytetar për rëndësinë dhe mbrojtjen e pyjeve, -Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve -Organizimi i kampeve verore për vëzhgimin e pyjeve, Promovimi i numrit Emergjent	KKSB, DBPZHR, Policia e Kosovës, Drejtoria e Inspektoratit, Drejtoria e Emergjencave dhe OJQ-të	-Ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve për kujdesin dhe mbrojtjen e pyjeve (natyrës). -Parandalimi i zjarreve në pyje. -Parandalimi i vërshimeve	Janar – Dhjetor	Buxheti Lokal dhe Qendror
12	-Identifikimi i lokacioneve dhe hapësirave të strehimit të banorëve ne rast të fatkeqësive natyrore	Identifikimi i vendeve për strehim Mirëmbajtja e hapësirave	Komuna DMSH		Janar- Dhjetor	Buxheti komunal dhe Donatoret

13	<p>-Rrezidqet nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera dhe Ambienti</p> <p>-Mbrojtje nga vërshimet dhe tërmete</p>	<p>-Projektet për reagim ndaj ETHKK (Ethet hemorragjike Krime-Kongo)</p> <p>-Zgjidhja e problemit të kafshëve të braktisura (qentë endacak dhe macet),</p> <p>-Fushata sensibilizuese nga lëmia e shëndetit publik, mbrojtjes nga zjarri.</p> <p>-Menaxhimi i mbeturinave (eliminimi i deponive joformale).</p> <p>-Mbatja e ligjëratave në shkolla mbi rëndësinë e marrjes së masave preventive</p> <p>-Pastrimi i deponive joformale të hedhjes së mbeturinave.</p>	<p>DKMSH, DKBPZHR, Drejtoria e Inspektoratit, DKSHMS, IKSHP, MBZHR.DMSH, Policia e Kosovës, FSK-ja, Kryetarët e bashkësiwe lokale.</p>	<p>-Ngritja e sigurisë së shëndetit të qytetarëve-minimizimi i rasteve të pickimit dhe viktimave.</p> <p>-Ngritja e nivelit të vetëdijes së qytetarëve mbi rëndësinë e shëndetit dhe mbrojtjen nga zjarri dhe rreziqe të tjera.</p>	<p>Janar-Dhjetor 2021</p>	<p>Buxheti Lokal dhe Qendror</p>
14	<p>-Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm</p>	<p>Mbatja e ligjëratave nëpër shkolla të mesme, mbatja e takimeve në bashkësi Lokale dhe fetare, organizimi i eventeve të ndryshme</p>	<p>Policia e Kosovë, Bashkësi të fetare, DA, OJQ-të, QPS, MPB</p>	<p>Ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve mbi rëndësinë e ekstremizmit të dhunshëm</p>	<p>Janar - Dhjetor</p>	<p>Nuk ka implikime buxhetore</p>

15	-Identifikimi i bizneseve ilegale "Lojërave të fatit" (Bastoreve, kazinove etj) -Siguria e të rinjve	Vizita në terren të bizneseve nga inspektorët komunal -Kontroll ruine pa paralajmërim të lokalëve të natës	Drejtoria e Inspektoratit ne bashkëpunim me përfaqësuesit e bashkësive lokale dhe EYSB -Policia e Kosovës	-Identifikimi dhe mbvllja e këtyre bizneseve -Identifikimi i përdoruesve të narkotikeve dhe gjetja e armëve pa leje. Parandalimi i adoleshenteve ne përdorimin e alkoolit nën moshën 18 vjeç	Janar-Dhjetor	Buxheti Komunal
16	-Përshtatshmëria dhe qasja fizike për personat me aftësi të kufizuara	-Rregullimi i gjitha trotareve duke ofruar përshtatshmëri dhe qasje për gjithë PAK; Rritja e numrit të parkingjeve për PAK	Drejtoria e Urbanizmit dhe Shërbimeve Publike	-Ofrimi qasjes fizike për PAK në trotaret e Komunës se Gjakovës; Lehtësimi i qasshmërisë për PAK Policia e Kosovës	Shkurt – Dhjetor	Buxheti Komunal
17	-Rritja e bashkëpunimit te trekëndëshit Mësimdhënës – Nxënës-Prindër	-Mbatja e takimeve të rregullta me nxënës, prindër dhe mësimdhënës	DKA, Shkollat, Këshillat drejtuese te shkollave (KDSH)	-Ulja e mungesave dhe delikuençës ne shkollat/ Rritja e sigurisë dhe cilësisë	Janar-Dhjetor	Buxheti Komunal Donacione
18	Parandalimi dhe luftimi i pandemisë Covid 19.	Zbatimi i masave të përcaktuara nga Institucionet përgrëgjëse për luftimin e Pandemisë Covid 19	Anëtarët e KKSBS-së dhe të Shtabit Emergjent.	Zvogëlimi i numrit të personave të prekur dhe menaxhimi i situatës së shkaktuar nga Pandemia Covid 19	Janar-Dhjetor	Buxheti Komunal

*Të raportohet çdo tre muaj nga anëtarët e KKSBS-së për veprimet e marra nga ndonjëra pike